

**URDHËR**  
**Nr. 1, datë 5.1.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 682, DATË 21.12.2020, “PËR NDALIMIN E LËVIZJES PËRMES RRUGËVE AJRORE ME BRITANINË E MADHE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 3, germa “a”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si dhe vendimit të Komitetit të përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri, datë 5.1.2021,

**URDHËROJ:**

Në urdhrin nr. 682, datë 21.12.2020, “Për ndalimin e lëvizjes përmes rrugëve ajrore me Britaninë e Madhe”, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi: “deri në datën 6.1.2021” zëvendësohet me togfjalëshin: “deri në datën 18.1.2021”.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË**  
**DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**Ogerta Manastirliu**